

VENDIM
Nr. 120, datë 9.6.2025

**MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR SHQYRTIMIN E KËRKESËS SË
SHOQËRISË “FIER THERMOELECTRIC” SHA PËR LICENCIM NË
VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të neneve 16 dhe 37, pika 2, germa “a”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; neneve 4, pika 1, germa “a”, 5, pika 1, germa “a”, dhe 10, pikat 1 dhe 3 të rregullores “Për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar; si dhe neneve 15 dhe 19, pika 1, germa “a” të rregullores “Për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 9.6.2025, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 1763/1 prot., datë 5.6.2025, të Drejtorisë së Licencimit dhe Autorizimeve “Mbi kërkesën e shoqërisë ‘Fier Thermoelectric’ sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike”,

konstatoi se:

- Shoqëria “Fier Thermoelectric” sh.a., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1763 prot., datë 26.5.2025, ka paraqitur kërkesën për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga termocentrali, me kapacitet të instaluar 170 mw, me vendndodhje në Roskovec, Fier.

- Nga shqyrtimi i aplikimit, në referencë të përcaktimeve të rregullores “Për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar, rezultoi se:

Përputhshmëria e aplikimit me rregulloren

- Në përputhje me nenin 9, pika 1 dhe 1.1 të rregullores, aplikuesi ka dorëzuar dokumentacionin e kërkuar për pajisjen me licencë sipas germave (“a”, “b” dhe “c”), duke plotësuar formularin sipas formatit të përcaktuar në shtojcën 1, ka paraqitur kërkesën për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, duke plotësuar të dhënat e subjektit, përfshirë emrin, NUIS-in, adresën, kontaktet dhe administratorin. Gjithashtu, aplikuesi deklaroi se nuk i është hequr apo refuzuar më parë një licencë, angazhohet për zbatimin e kuadrit ligjor dhe rregullave të ERE-s, si dhe ka kryer pagesën e aplikimit sipas aneksit A.

- Në përputhje me nenin 9, pika 1.2 të rregullores, aplikuesi ka dorëzuar dokumentacionin juridik dhe administrativ të kërkuar sipas germave (“a”, “b” dhe “d”).

- Në përputhje me pikën 1.3 të rregullores, aplikuesi ka dorëzuar dokumentacionin financiar dhe fiskal të kërkuar sipas germave (“a” dhe “c”).

- Në përputhje me pikën 2 të rregullores, aplikuesi ka dorëzuar dokumentacionin specifik për licencimin në sektorin e prodhimit të energjisë elektrike sipas germave (“b”, “e” dhe “f”).

Pajisja e shoqërisë me leje dhe miratime të tjera

- Shoqëria ka nënshkruar me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE) kontratën nr. 682 rep., nr. 210 kol., datë 31.1.2025, “Për ndërtimin, shfrytëzimin dhe administrimin e termocentralit, me kapacitet prodhues 170 mw dhe veprave ndihmëse, i cili nuk është objekt koncesioni në Roskovec, qarku Fier, nga shoqëria “Fier Thermoelectric” sh.a.”.

- Shoqëria është pajisur me deklaratë mjedisore, lëshuar më 13.11.2023 nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit (AKM), për zhvillimin e projektit “Implant energjetik me cikël të kombinuar”.

- Në këtë aplikim duhet të plotësohet dhe sa vijon:

Neni 9

Formati dhe dokumentacioni për aplikim

Pika 1, “Dokumentacioni i përgjithshëm për të gjitha aplikimet për pajisje me licencë”

Pika 1.2, “Dokumentacioni juridik dhe administrativ”

- **Germa “c”:** Shoqëria duhet të informojë në rast se stafi përkatës është aktualisht pjesë përbërëse e shoqërisë, apo do të bëhet efektiv kur të fillojë operimi i veprimtarisë.

Pika 1.3, “Dokumentacioni financiar dhe fiskal”

- **Germa “b”:** Shoqëria duhet të depozitojë dokumentacionin që vërteton se ka siguruar mjetet e nevojshme financiare për realizimin e plotë të projektit të TEC-it.

Pika 2, “Dokumentacioni specifik sipas tipit të licencës”

Pika 2.1, “Për t’u pajisur me licencë për prodhimin e energjisë elektrike, aplikuesi duhet të depozitojë, gjithashtu”:

- **Germa “a”:** Shoqëria duhet të bëjë saktësimet përkatëse, për sa i përket numrit të njëjësive gjeneruese dhe datës së fillimit të operimit.

- **Germa “c”:** Shoqëria duhet të depozitojë në miratimin përfundimtar të pikës së lidhjes/marrëveshjen e nënshkruar me Operatorin e Sistemit të Transmetimit (OST) sh.a.

- Rezulton se shoqëria disponon aktualisht një deklaratë mjedisore të vlefshme (deri më 13.11.2025), por duke marrë në konsideratë se ka deklaruar se ndërtimi i TEC-it do të fillojë në vitin 2025 dhe duke qenë se nga shoqëria nuk është dhënë ndonjë informacion në lidhje me fillimin e zbatimit në terren të projektit, vlerësohet t’i kërkohej ky informacion në vijim.

- Po ashtu, shoqëria duhet të japë informacion në lidhje me nevojën ose jo të pajisjes së këtij TEC-i me leje të përdorimit të burimit ujqor për të realizuar procesin e ftohjes.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “Fier Thermoelectric” sh.a. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga termocentrali, me kapacitet të instaluar 170 mw, me vendndodhje në Roskovec, qarku Fier.

2. Drejtoria e Licencimit dhe Autorizimeve të njoftojë shoqërinë “Fier Thermoelectric” sh.a. dhe Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit, në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi, apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti